



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Prilajeno:	03.07.2024	
Mjesia Jednica:	Numri Broj:	Shtojca Dodatak:
01-052/01-31627		



KOMUNA E LIPLANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPLAN

### ZYRA E KRYETARIT

<b>Datë:</b>	03.07.2024
<b>Referencë:</b>	
<b>Për:</b>	Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi –Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
<b>Kopje:</b>	Diamant Bytyqi– Nënkyetar i Komunës Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës
<b>Nga:</b>	Komisioni për hartimin e Planit në bashkëpunim me Zyrtarin përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit.
<b>Lënda:</b>	Raport nga procesi i konsultimit publik nga Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026

### Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Komisioni për hartimin e Planit komunal të veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026 dhe Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standarteve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit kanë shpallur në:

### KONSULTIM PUBLIK

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026

Ku është publikuar edhe njoftimi me bashkëlidhjen e konsultimeve publike ku ka qenë në diskutim publik ky dokument si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetet sociale të komunës si dhe në platformen e konsultimeve publike të Qeverisë së Kosovës.

Shih linqet:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42441>

[https://kk.rks-gov.net/lipjan/?page\\_id=200034772](https://kk.rks-gov.net/lipjan/?page_id=200034772)

### **Ecuria e Procesit**

Komisioni për hartimin e Rregullores në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispoziatat e Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna. Në bashkëpunim

me kordinatorin për konsultime publike ka publikur në web faqen e komunës njoftimin me datë 05.06.2024 për mbajtjen e konsultimit-debatit publik për Planin komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026 njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetet sociale të komunës.

**në linkun:**

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2024/06/Njoftim-per-Debat-publik-Plani-i-Veprimit-kunder-braktisjes-dhe-moregjistrimit-te-shkolles-1.pdf>

Ndërsa takimi konsultativ-debati është realizuar në kohën e paraparë dhe me dt. 13.06.2024 është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit duke filluar nga ora 14:00

Drejtori i Arsimit në Komunën e Lipjanit, z. Rasim Hasani hapi takimin dhe prezentoj para të pranishmëve këtë draft plan që synon koordinimin e veprimeve ndërinstitucionale dhe ngritjen e kapaciteteve në nivel lokal dhe shkollor në zbatim të detyrimeve ligjore për parandalim dhe

reagim ndaj braktisjes dhe mosregjitrimit të shkollës, duke rritur përfshirjen e fëmijëve në arsim dhe zvogëlimin e braktisjes.

Drejtori Hasani tha se DKA në Lipjan është e përkushtuar në krijimin e kushteve për edukim cilësor të të gjithë nxënësve dhe avancim të vazhdueshëm profesional të mësimeve në përputhje me Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Kosovës.

Drejtori Hasani, para të pranishmëveka prezantuar komisionin në përbërje:

1. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit për Arsim, kryesues,
2. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtar,
3. Vlora Krasniqi, Shefe e Sektorit për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore, anëtare
4. Astrti Buja, Drejtor i SHFMU “Nezë Bujani” Bujan, anëtar,
5. Valona Zeqiri, Psikologe, anëtare,
6. Teuta Berisha, Zyrtare në Drejtoratin për Arsim, anëtare
7. Faton Mejzninolli, Këshilli i Prindërve, anëtar



Duke i falenderuar anëtarët për kontributin e tyre në hartimin e këtij Plani z.Hasani ka vazhduar prezantimin duke përmendur edhe Qëllimi i planit të punës si dhe Objektivat e përgjithshme në

Parandalimi dhe Identifikimi i hershëm i nxënësve në rrezik të braktisjes dhe ofrimi i ndërhyrjeve të duhura për t'i mbështetur ata, si këshillim, mbështetje dhe mentorim.



Drejtori Rasim Hasani ka folur edhe për Koordinimin e veprimeve ndërinstitucionale dhe ngritjen e kapaciteteve në nivel lokal dhe shkollor në zbatim të detyrimeve ligjore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjitrimit të shkollës, duke rritur përfshirjen e fëmijëve në arsim dhe zvogëlimin e braktisjes. Ai gjithashtu ka përmendur edhe Rezultatet kryesore të pretenduara si:

- Rritja e monitorimit dhe mbikëqyrjes nga inspektorati
- Funksionalizimi i EPRMB në Komunë dhe në të gjitha shkollat
- Në fund të secilit vit pretendojmë rezultate konkrete për numrin / përqindjen e rasteve të zgjidhura
- Përgjigjja ndaj rasteve të nx. të panotuar dhe me shumë mungesa
- Rritja e raportimit cilësor nga shkollat/ zvogëlimi i braktisjes

Por njëkohësisht ka theksuar edhe implikimet buxhetore që ka Plani dhe monitorimin e këtij dokumenti.

Nga ana tjetër të pranishmit paten rastin të inkuadrohen ne debat dhe të japin kontributin e tyre për të kompletuar këtë dokument të rëndësishëm.

**Ne po i paraqesim komentet e të pranishmëve nga takimi-debati konsultativ lidhur me Planin komunal të veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026**

Temat e Konsultimit	Komentet	Kush ka komentuar	Përgjigje në pyetjet / komentet e parashtruara	Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026	Ka pyetur se a janë të formuara EPRBM –të në të tri nivelet e shkollimit dhe a janë funksionale ato si dhe a janë të përfëshira në këtë plan të veprimit edhe shkollat e mesme.	<b>Servete Thaqi</b>	Komisioni pas shqyrtimit ka aprovuar komentin dhe ka potencuar se Sipas udhëzimit administrative 08/2018 Themelimi dhe fuqizimi i EPRBM-ve neni 3 EPRBM-të themelohen në nivel shkolle, DKA-komunë dhe në nivel nacional. Në disa shkolla ekipet janë më aktive dhe kjo mvaret nga numri i nxënësve braktisës.	Komenti u pranua plotësisht
Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026	Ka shprehur interesim të dijë se a do të jetë me pagesë ekipi në nivel komune.	<b>Hasan Luma</b>	Komisioni ka pranuar komentin duke thënë se Në draft planin e veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit	Komenti u pranua plotësisht

			gjithsesi ë eshtë parapar edhe një kosto financiare mirpo kjo kosto eshtë e paraparë për aktivitetet që do të bëhen dhe jo për ekipin sepse janë disa aktivitete që janë paraparë e që kanë një kosto të caktuar si psh organizimi i takimeve informuese, trajnimet fushatat sensibilizuese, puna në teren etj.	
--	--	--	---	--

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë **16** pjesëmarrës, prej tyre femra **8** dhe meshkuj.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuuesve
15-30 ditë pranohen komentet		16
15- 30 ditë pranohen komentet		

**Bukurie Zejnullahu-Jashari**

**Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike**

**Shtojcë: Lista e pjesëmarrësve**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Plani I veprimt kundër braktisjes dhe mosregjistrimit ne shkollë

REGJISTRI I PJESMARRËSVE NË DEBATIN PUBLIKË 13.06.2024

Nr.	Emri	Mbiemri	Vendbanimi	Nr I telefonit	Nënskrimi
1	Basim	Hasim	K'obrinë		
2	Basim	Durisi	Lipjan	044-436804	
3	VLOKA	KRAMUQI	LIPJAN	044-583415	
4	SALIH U	LIRA	LIPJAN	044 556061	
5	PRAGM	MURAH	LIPJAN	044/454567	
6	Semirke	SHAGI	Lipjan	044561-529	
7	Malona	Ferisi	Lipjan	044-495-488	
8	Steda	BERMBA	Lipjan	044-447-447	
9	IlexRide	Gashi	Lipjan	045805333	
10	FRONI	Hëzinoceri	Lipjan	049458355	
11	Qendesa	Shkabaj	Lipjan	11	
12	Vahode	Shaj	Shoni	11	
13	Asim	Jaku	Lipjan	044/401-548	
14	ROZETA	JELIHI	BAPULJE	045-282098	
15	Albert	MUSTOJA	Lipjan	044/558-960	
16	Asteit	PURA	Lipjan	044/368-475	
17					
18					
19					
20					
21					
22					
23					
24					
25					